



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF
GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Komuna e Gjakovës

Në bazë të nenit 72.1 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, nenit 42.1, nenit 38, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe kërkesës së menaxherëve të kontratës me numër identifikimi : 632-24-9630-5-2-1 dhe numër të brendshëm 632-24-106-521, dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-16775, për shkak të pamundësisë së përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktuesit, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore më dt. 28.03.2025, Zyrtari përgjegjës i prokurimit, Ju njofton:

NJOFTIM

Për ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës

Neni 42, paragrafi 42.1 i KPK përcakton se "Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën"

Neni 38, paragrafi 38.1 i KPK përcakton se: "**Force Majeure**" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

Me dt.26.03.2025, Menaxherët e kontratës i është drejtuar Zyrës së Prokurimit, me kërkesë për shkëputjen me marrëveshje të kontratës "Rregullimi i instalimit elektrik në shkollat "Yll Morina", "Selman Riza" dhe "Mazllom Këpuska", e lidhur me dt.01.11.2024, me numër të prokurimit : 632-24-9630-5-2-1 dhe numër të brendshëm 632-24-106-521, dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-16775.



Sipas Menaxherëve të kontratës, në shkollat “Yll Morina” dhe “Selman Riza”, punët janë kryer sipas planit dinamik, kurse në shkollën “Mazllom Këpuska” punimet nuk kanë mundur të realizohen për arsye se:

- gypat për të cilën kanë qenë në Pëlqim Elektroenergjetik të KEDS-it, nuk ka mundur të realizohen sepse Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit nuk ka lejuar demolimin e kubëzave ;

- pas kërkesës për revidim të Pëlqimit Elektroenergjetik në KEDS, i njëjti nuk ka dhënë 137 pëlqim për revidim, prandaj projekti nuk mund të realizohet.

Andaj, bazuar në nenin 42, paragrafi 42.1 dhe nenin 38, paragrafi 38.1 të KPK, si dhe kërkesën e dt.26.03.2025, të menaxherëve të kontratës, palët kontraktuese kanë arritur në përfundim që të bëhet ndërprerja e kontratës me marrëveshje mes dy palëve kontraktuese.

Nga sa u tha më lartë, ju informojmë se kontrata e nënshkruar me datën 01.11.2024, me numër të prokurimit : 632-24-9630-5-2-1 dhe numër të brendshëm 632-24-106-521, dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-16775, me titull “ Rregullimi i instalimit elektrik në shkollat “Yll Morina”, “Selman Riza” dhe “Mazllom Këpuska”, ne mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të punëve “VOLTECHZ” sh.p.k., Magj.Prishtinë Ferizaj – Gracanice, Prishtinë, me numër unik 810066680, do të ndërpritet me marrëveshje mes dy palëve me date 01.04.2025.

Palët janë pajtuar që nuk do të ketë kërkesë për dëmshpërblim nga ana e Kontraktuesit e as penalizim nga ana e Autoritetit kontraktues.

Shkresës i bashkëngjiten kërkesa e Operatorit ekonomik , rekomandimi i Menaxherëve të kontratës për shkëputje të kontratës, shkresat e KEDS-it dhe Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Me respekt,

për: 
Udhëheqës i zyrës së Prokurimit





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



DATË:	26.03.2025
REFERENC-Ë:	zyrt.04
PËR/ZA/TO:	Zyra e Prokurimit, Faton Gutaj – Gjakovë
CC:	Kryetarin e Komunës – Ardian Gjini
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtoria e Arsimit– Eranda Kumnova Baçi
NGA/OD/FROM	Menaxheret e Kontratës – Hysen Brahimaj, Ilir Zhubi
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për Nderprerje te Kontratës me Pajtimin e Palëve Kontrata: “Rregullimi i instalimit elektrik ne shkollat “Yll Morina”, “Selman Riza” dhe “Mazllum Këpuska ”

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese ju njoftojmë se bazuar në Kërkesën e datë 25.03.2025 nga Operatori Ekonomik Voltechz” Sh.p.k – Magj Prishtinë Ferizaj – Grancanice, Prishtina, kërkojmë me mirëkuptim të mundësoj shkëputjen e kontratës:

- **Titulli i kontratës:** Rregullimi i instalimit elektrik në shkollat “Yll Morina”, “Selman Riza” dhe “Mazllom Këpuska”
- **Nr. të prokurimit:** 632-24-9630-5-2-1/C1012
- **Vlera e kontratës:** 33,333.36€
- **Data e nënshkrimit të kontratës:** 01.11.2024

Palët e kontratës:

- **Autoriteti Kontraktues:** Komuna e Gjakovës dhe
- **Operatori Ekonomik:** Voltechz” Sh.p.k – Magj Prishtinë Ferizaj – Grancanice Prishtina

1. Hyrje dhe Kontekst:

- Komuna e Gjakovës ka nënshkruar kontratë me Operatorin Ekonomik Voltechz” Sh.p.k – Magj Prishtinë Ferizaj – Grancanice Prishtina, më datë: 01.11.2024 për realizimin e punëve sipas kontratës: " Rregullimi i instalimit elektrik në shkollat “Yll Morina”, “Selman Riza” dhe “Mazllom Këpuska”.
- Sipas kontratës vlera e kontratës është 33,333.36€, kurse është realizuar 10,077.00 euro, mbetja e kontratës është 23,256.36 euro.

2. Arsytimi për Ndërprerje e kontratës me Pajtimin e Palëve:

- Kontrata ” Rregullimi i instalimit elektrik në shkollat “Yll Morina”, “Selman Riza” dhe “Mazllom Këpuska” është kontratë me të cilën ka pasur të punohet në tri shkolla, në shkollën Yll Morina dhe Selman Riza janë kryer punimet sipas planifikimit nga OE Voltechz” Sh.p.k mirëpo në shkollën Mazllom Këpuska nuk ka mundur të realizohen punimet për arsye:

a)Gypat për të cilën kanë qenë në Pëlqim Elektroenergjetikë të KEDS nuk ka mundur te realizohen për arsye se Drejtoria e Urbanizmit e cila nuk ka lejuar demolimin e kubëzave.

b) Pas kërkesës për revidim të Pëlqimit Elektroenergjetikë nr. 6076 në KEDS, nuk ka dhënë pëlqim për revidim kështu që projekti nuk mund të realizohet.

- ## 3. Marrëveshje të përbashkët:
- Duke marrë parasysh kërkesat në vend dhe pozicionet e mbetura nga kontrata , Komuna e Gjakovës dhe Voltechz” Sh.p.k – Magj Prishtinë Ferizaj – Grancanice Prishtina, bien në ujdë që kontrata të ndërpritet. Është zgjidhja më e arsyeshme dhe e drejtë për të dy palët. Kjo marrëveshje është bërë me mirëkuptim të plotë dhe në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë marrëdhëniet kontraktuale. Është bërë vlerësimi i punimeve të kryera dhe është bërë prerja e punimeve të ngelura pa u përfunduar (Shkolla “Mazllom Këpuska”).

- Përfundim:

Në përputhje me situatën e krijuar dhe në frymën e bashkëpunimit, palët pajtohen që të ndërpresin kontratën për projektin " Rregullimi i instalimit elektrik në shkollat “Yll Morina”, “Selman Riza” dhe “Mazllom Këpuska”

4.

Të dyja palët janë të pajtuara që ky vendim është në të mirë të interesave të tyre dhe në përputhje me parimet e drejtësisë dhe transparencës.

From: Hysen Brahimaj
Sent: Tuesday, March 25, 2025 2:52 PM
To: Ilir Zhubi
Subject: FW: Kerkese

Me respekt,
Hysen Brahimaj
Udhëheqës i Sektorit për Shërbime të Përbashkëta
Drejtoria e Arsimit- Gjakovë
Kontakt +383 44 125 229
E-mail:hysen.brahimaj@rks-gov.net

GJAKOVA



Komuna Gjakovës
Kosovë 50000

From: VOLTECHZ SH.P.K <info@voltechz.com>
Sent: Tuesday, March 25, 2025 10:02 AM
To: Hysen Brahimaj <hysen.brahimaj@rks-gov.net>
Subject: Kerkese


Caution! This message was sent from outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

Pershendetje i nderuar, po ju shkruaj ne lidhje me kete kontrat. Siq edhe jeni informu disa here ne teren keds ne specifikat e veta ka kerku qe te hapet kanal me 4 gypa prej TS deri te pika kyqese dhe te vendoset nje shtylle 9/1000 per TU , qe eshte e pa pranueshme nga ana juaj dhe zgjidhja qe po kerkoni ju eshte njekohsisht e pampranueshme nga keds siq edhe na kane njoftu keds me leter informuese. Pasi qe koha po ecen dhe ne vetem po bejme pagesa te sigurimeve dhe ato nuk po na rimbursohen nga ana juaj kerkojme qe kjo kontrat te mbyllet dhe te rregullohen dokumentet me Keds sepse ne po demtohem ne cdo aspekt.
Shpresoj ne mirkuptimin tuaj.

Me respekt / Best Regards

Management of Voltechz shpk / Menaxhmenti i Voltechz shpk



	NJËSIA E SHËRBIMEVE ME KONSUMATORË	Nr.	KEDS-DCC-F-DCC-06
		Faqe	Faqe 1 nga 1
	PËRGJIGJE	Versioni	1.0

Për: B6. 32400 Shkolla fillore Mazllom Këpuskë

Adresa: Rr. Ismail Qemali, Gjakovë

KEDS - SH. A.

Nr. 19473 dt. 23 DEC 2024
PRISHTINË VII

Lënda: 100 [XII] 2024

TIC: 1693476

Përmes Arkivës
Prishtinë (Qendër)

Departamenti për Shërbime me konsumatorë në KEDS duke u mbështetur në Kreun III, përkatësisht nënin 10 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë dhe duke pasur parasysh kushtet teknike në atë zonë, ka shqyrtuar kërkesën tuaj dhe përmes kësaj

PËRGJIGJE

ju informon që kërkesa juaj për Revidim të Pëlqimit Elektroenergjetik nr. 6076 dt. 14.05.2024 refuzohet dhe mbesin në fuqi kushtet teknike të dhëna me PEE paraprak.

Arsyetim: Kërkesa juaj refuzohet pasi që mbi objektin për PEE kalon LP 10(20)kV J11 Gjakova III me kod: 81000116 andaj vlen Zgjidhja Teknike e dhënë përmes Pëlqimit Elektroenergjetik me nr. 6076 dt. 14.05.2024

Këshillë juridike: Ju keni të drejtë ankese ndaj kësaj përgjigje në ZRrE, adresa: rr. Bekim Fehmiu (Ish Ndërtesa e Fazitës), kati: 2, 10000 Prishtinë në afatin prej 14 ditëve pas pranimi të përgjigjes.

Me respekt,

Inxhinier për LR


Shkurtesa BLAKAJ

Ekzemplar

IX Palës


IX Njësia SHK

IX Arkivi

Menaxher për SHK


Blerton MUSTAFA

Drejtor i DSHK (KEDS)


Sabri TËRNAVA



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data:	02.12.2024
Nr.lëndës:	07-351/01-17685
Për:	Drejtoria e arsimit - KK Gjakovë.
Nga:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit Zyrtare për Infrastrukturë: Jeton Dalladaku inxh.dipl.ark. UD
Përmes:	Drejtorit të DUMM, Arben Bakalli
Lënda:	Njoftim

Lidhur me kërkesën e tuaj me të cilën keni kërkuar të pajiseni me leje për kycjen e Shkolles fillore "Mazllom Kepuska" në rrjetit nëntokësor të tensionit të mesëm 10(20) kV që ndodhet në rrugën "Izet Hima" Z.K Gjakovë-Qytet konform- Pëlqimit Elektroenergjetik dhe Zgjidhje Teknike me nr. 6076 të dt: 14.05.2024 të lëshuara nga KEDS, ju njoftojmë me sa vijon:

Aktualisht trasa e propozuar e atakon rrugën "Izet Hima" e cila sapo eshte përfunduar me kubeza te reja andaj duhet të bëhet zgjidhje teknike e re që te mos dëmtohet prona publike. Ekzekutimi i kanalit nëntokësor elektrik sipas kërkesës tuaj nuk mund të lejohet, njëkohësisht pasi që është përfunduar rregullimi i rrugës nga Komuna e Gjakoves.

Kërkesa juaj me nr.07-350/01-17685 e dt: 26.11.2024 - **Refuzohet**, deri në zgjidhjen teknike të re nga KEDS (e cila mund te realizohet nëpër oborr të shkollës prej trafos ekzistuese duke depërtuar ne hapsiren teknike te shkolles dhe me dalje në rr."Zenel Luzha").

Me respekt!